



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 507/138 prot.

Tiranë më 11 . 11 .2020

VENDIM

Nr. 47/10, datë 11.11.2020

“PËR MARRJEN E MASAVE NË LIDHJE ME COVID - 19”

Bazuar Ligjin Nr. 98 datë 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 27, 28 dhe 38, që parashikojnë përkatësisht funksionimin dhe kompetencat e Këshillit të Gjykatës, Aktit normativ Nr. 9 datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë, gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid – 19”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 143, datë 22.04.2020, “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”, Udhëzimi Nr. 146, datë 27.04.2020, “Për përcaktimin e masave dhe kufizimin e përhapjes së Covid – 19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.11.2020, Këshilli;

KONSTATON

Për marrjen e masave kundër Covid – 19 dhe zbatimin e protokollit të sigurisë sipas Rregullores “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid – 19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, miratuar me vendimin nr. 47/4 datë 24.04.2020, “Mbi përcaktimin e rregullave dhe praktikave të duhura për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid – 19, gjatë zhvillimit të veprimtarisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”, si dhe në funksion të reduktimit të infeksionit;

VENDOSI

1. Pezullimin e gjykimeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 13 deri në 27 Nëntor 2020, me përjashtim të çështjeve me karakter urgjent, sipas Aktit normativ Nr. 9 datë 25.03.2020.
2. Ky vendim do të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në ambientet e jashtme të saj dhe hyn në fuqi me njëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Petrit ÇOMO

ANËTAR
Altin SHKURTI



ANËTAR
Donald XHELILI